V E N D I M
Nr. 155, datë 25.4.2002

PËR FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRAT E ENTIT SHTETËROR TË FARËRAVE DHE FIDANËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fianëve funksionon në varësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe ka për objekt të punës organizimin dhe kontrollin e të gjithë veprimtarisë, që zhvillohet për materialin mbjellës, bimor, në zbatim të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor".

2. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve ka këto të drejta:

a) të kontrollojë kudo ku prodhohet, riprodhohet, shumëzohet, përpunohet e magazinohet, transportohet, eksportohet, importohet dhe tregtohet material mbjellës, bimor;

b) të bashkëpunojë me organizmat ndërkombëtarë si motra, të vendeve të tjera në fushën e materialit mbjellës, bimor;

c) të bashkëpunojë me institutet kërkimore-shkencore të vendit dhe të jetë bashkërendues i punës së tyre për çvënien në dukje, grumbullimin, studimin dhe ruajtjen e materialeve gjenetike bimore, si dhe me çdo fermer apo subjekt, që ka në pronësi bimë bujqësore, me vlerë gjenetike.

ç) Të organizojë, sipas kërkesave, trajnime për marrjen e mostrave, kryerjen e analizave laboratorike të materialit mbjellës, bimor dhe të japë certifikatë trajnimi.

3. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve përgjigjet për kryerjen e këtyre detyrave:

a) organizmin e punës dhe marrjen e masave për zbatimin e ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor" dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

b) kryerjen dhe mbikëqyrjen e pronave zyrtare të testimit të variteteve të reja të krijuara në vend dhe/ ose të ardhura nga vende të tjera, për regjistrimin e tyre në Regjistrin Themeltar dhe katalogun zyrtar të specieve dhe të variteteve;

Provat zyrtare të testimit të variteteve kryhen në jo më pak se dy vjet për bimët e arave dhe në jo më pak se dy vjet pas hyrjes në prodhim për bimët drufrutorë. Kryerja e provave zyrtare realizohet në këto zona:

- Për bimët e arave: Shkodër, Lushnjë, Korçë dhe Tiranë.
- Për bimët drufrutorë: Tiranë, Vlorë, Sarandë, Korçë, Shkodër dhe Dibër.

Në bazë të të dhënave të provave dhe atyre laboratorike të realizuara, përgatit raportin me shkrim për shqyrtim në Komisionin Shtetëror të Atestimit të Varieteteve.

c) Kryerjen e analizave laboratorike për treguesit cilësorë të varieteteve, që testohen dhe analizave zyrtare të materialit mbjellës, bimor të përcaktuar për tregtim, në laboratorin e ngritur pranë Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve. Gjithashtu, ky Ent mbikëqyr kryerjen e analizave zyrtare në laboratorët e autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;

ç) ndjekjen e funksionimit të Bankës Gjenetike dhe të realizimit të detyrave që përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit për vënien në dukje, grumbullimin, ruajtjen, studimin dhe vlerësimin e materialit gjenetik bimor, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet kërkimore-shkencore dhe subjektet që zotërojnë material bimor me vlera gjenetike;

d) dhënien e lejeve, sipas kërkesave dhe kritereve të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit për prodhimin, riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës, bimor për tregtim;

dh) mbajtjen dhe plotësimin e Regjistrit Themeltar të specieve dhe të varieteteve dhe marrjen e masave të sigurisë për ruajtjen e tij;

e) botimin e katalogut zyrtar të specieve dhe të varieteteve të listave A dhe B, çdo pesë vjet,

ndërsa ndryshimet vjetore bëhen me shtesa të katalogut zyrtar të specieve dhe varieteteve e sipas rastit dhe sipas listave A dhe B;

f) përgatitjen e etiketës zyrtare, sipas përcaktimeve përkatëse, dhe marrjen e masave të sigurisë për ruajtjen dhe shpërndarjen e saj;

g) organizimin e sistemit të të dhënave dhe hartimin e rregullave për përmirësimin e vazhdueshëm të marketingut të materialit mbjellës, bimor, sipas kritereve që përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko